



Komisioni Evropian

Të kuptojmë Zgjerimin

Politika për zgjerimin e Bashkimit Evropian







Shtefan Fyle

Komisioner i Bashkimit Evropian për Zgjerimin dhe Politikën Evropiane të Fqinjësisë

Duke kaluar nga gjashtë anëtarë në vitet e 50-ta deri në 27 në vitin 2007, Bashkimi Evropian tani është bërë vatrë e mbi 500 milionë njerëzve. Me shtrirje që nga Atlantiku e deri tek Deti i Zi, BE-ja sot bashkon pjesët perëndimore me pjesët lindore të Evropës. Komuniteti u krijua për të inkurajuar paqe dhe stabilitet në kontinent, dhe ky qëllim mbetet sot po aq relevant sa që ishte atëherë. Përgjatë rrugës, kësaj përpjekjeje i janë bashkangjitur anëtarë të rinj dhe BE-ja ka përparuar, është më e fuqishme dhe ka ndikim më të madh.

Politika për zgjerimin e BE-së bën Evropën vend më të sigurt, që ka në qendër të vëmendjes konsolidimin e shtetit ligjor, duke promovuar në të njëjtën kohë demokracinë dhe liritë themelore nëpër shtetet që synojnë të bëhen anëtare, e që janë fqinjët tanë më të afërt. Zgjerimi na lejon të promovojmë vlerat dhe interesat tona. Ai na mundëson të marrim rolin e aktorit global.

Ne projektojmë vlerat e përbashkëta që bashkojnë Evropën përtej kufijve, në një nivel ndërkombëtar që karakterizohet me ndryshim dhe pasiguri. Një bashkësi që ndërton bashkëpunim mes rivalëve të mëparshëm, duke mbështetur ndërkohë standardet e të drejtave të njeriut, do të vazhdojë të mbajë ndikimin e duhur për t'i dhënë formë botës rreth saj.


BE-ja po vazhdon punën me këtë besim. Qeveritë e 27 Shteteve Anëtare, të bashkuara nën Këshillin Evropian, kanë rënë dakord rreth perspektivave për anëtarësim të Ballkanit Perëndimor, Turqisë dhe Islandës, të cilat kanë zgjedhur modelin e vlerave të bazuar në BE.

Për të vazhduar suksesin, politika e BE-së për zgjerim duhet të mbetet e besueshme. Besueshmëria është rrugë dykahëshe. Për shtetet anëtare, besueshmëria e procesit të zgjerimit do të thotë që një shtet kandidat rekomandohet për anëtarësim atëherë kur është i përgatitur plotësisht. Besueshmëria e shteteve që synojnë anëtarësimin qëndron tek angazhimi i tyre i sinqertë me reformat e BE-së. Angazhimi drejt procesit të zgjerimit do të jetë faktori përcaktues në sigurinë që kjo është një politikë që sjell fitim për të gjitha shtetet e përfshira.

Përdërisa vazhdon të zgjerohet, BE-ja duhet t'u kushtojë vëmendje të veçantë qytetarëve të saj dhe pikëpamjeve e shqetësimeve të tyre. Sepse vetëm me mbështetjen e plotë të qytetarëve të BE-së, vendimmarrësve të vërtetë, BE-ja është në gjendje të plotësojë një nga politikat e saj më të suksesshme - zgjerimin.

Ne duam që politika për zgjerimin e BE-së të jetë e qartë dhe e lehtë për t'u kuptuar nga gjithë qytetarët. Kjo broshurë paraqet historinë e këtij procesi dhe mënyrën e krijimit të Bashkimit Evropian, si që e njohim sot. Ajo shpjegon kushtet për t'u bashkangjitur BE-së, kush vendos nëse kandidatët janë të gatshëm, si funksionon procesi i zgjerimit, dhe çfarë pritet në të ardhmen e BE-së dhe shteteve që duan t'i bashkangjiten.

Shtefan Fyle



As Komisioni Evropian dhe asnjë person që vepron në emër të Komisionit nuk përgjigjet për atë se si do të përdoren informatat në vazhdim.

Një pjesë e madhe e informatave shtesë rreth Bashkimit Evropian janë në dispozicion në Internet. Ato mund t'i gjeni në serverin Europa (<http://europa.eu/>).

Informata për zgjerimin e Bashkimit Evropian mund të gjeni në ueb faqen e Drejtorisë Gjenerale për Zgjerim (<http://ec.europa.eu/enlargement/>).

Të dhënat e katalogimit mund t'i gjeni në fund të këtij botimi.

Komisioni Evropian, Drejtoria Gjenerale për Zgjerim, 2011
© Bashkimi Evropian 2011

Përkthyer nga Delegacioni i Bashkimit Evropian nga botimi në gjuhën angleze, i publikuar nga Zyra e Botimeve.

Dorëshkrimi u përfundua në qershor 2011

Fotografitë e kopertinës - nga lart-poshtë, nga e majta në të djathtë:

Fotografitë: 1,2 dhe 6- © plainpicture agency; 3 dhe 4 - © Bashkimi Evropian, 2011, Biblioteka audio-vizuele e Komisionit Evropian/Alen Shreder; 5 - © Agjencia Getty

Riprodhimi i tekstit autorizohet me kusht që burimi të jetë i njohur.

Shtypur në ish Republika Jugosllave e Maqedonisë

Nga gjashtë, në 27 Shtete Anëtare	4
Kush mund të bëhet anëtar?	6
Kush vendos?	8
Si funksionon procesi i zgjerimit: plotësimi i kërkesave	9
Ndihma e shteteve kandidate në përgatitjet për anëtarësim	14
E ardhmja	16




Nga gjashtë, në 27 Shtete Anëtare

Më 25 mars të vitit 1957, liderët e gjashtë shteteve që akoma po e merrnin veten nga dëmet e luftës, u takuan në Romë për nënshkrimin oficial të Traktateve, gjë që rezultoi në lindjen e një bashkësie të cilën sot e quajmë Bashkimi Evropian. Ky ishte një hap i pangjarë më parë, i cili kërkonte shumë guxim e vizion: shtetet që kishin luftuar kundër njëri tjetrit me shekuj u dakorduan të marrin vendime së bashku për çështje esenciale për të ardhmen e tyre të përbashkët. Ata gjithashtu u dakorduan të transferojnë një pjesë të fuqisë së tyre në një nivel të ri, nivel të cilit sot i referohemi thjesht si Bashkimi Evropian.

BE-ja ishte një sukses historik. Ajo i solli popujve të saj periudhën më të gjatë të paqes dhe prosperitetit në nivel të pakrahasueshëm. Ajo që filloi si një klub prej gjashtë anëtarësh është tani vatër për 27 shtete me popullsi prej mbi 500 milionë njerëz.

Integrimi i anëtarëve të rinj ishte pjesë e planit që nga fillimi. Krijuesit kishin besim të mjaftueshëm për të lënë derën hapur, në mënyrë që të bashkangjiten edhe shtete të tjera evropiane. Ndihma për shtetet që kanë prirje për t'u anëtarësuar ka qënë përgjigja e BE-së ndaj ndryshimeve në fushën politike evropiane gjatë pesë dekadave të shkuara, duke mundësuar nxitjen e rritjes ekonomike dhe solidaritetit, dhe forcimin e fuqive demokratike në shtetet që dalin nga diktatura.



Bashkimi Evropian ka sjellur shumë përparësi për të gjithë evropianët - stabilitet, prosperitet, demokraci, të drejta të njeriut, liri themelore, dhe shtetin ligjor. Këto nuk janë vetëm parime abstrakte. Ato kanë rritur cilësinë e jetës së miliona njerëzve. Dobitë e një tregu të vetëm për konsumatorët në BE janë të dukshme: rritja ekonomike dhe krijimi i vendeve të punës, mallra të konsumit më të sigurt, çmime më të ulëta, dhe zgjedhje më të gjerë në sektore siç janë telekomunikacioni, bankat dhe udhëtimi ajror, për të cekur vetëm disa.

Duke shumëfishuar këto mundësi, zgjerimi i BE-së ka qënë i dobishëm për të gjitha ekonomitë evropiane. Kriza ekonomike dhe financiare ka vënë bashkësinë dhe valutën evropiane në një sprovë të papërzjetuar më parë. Ajo ka treguar që

anëtarët janë të varur në mënyrë reciproke dhe se nevojiten forma të reja të solidaritetit dhe bashkëpunimit ekonomik për t'u ballafaquar me sfidat e ekonomisë globale. Kur reagimet ndaj krizës analizohen në nivel global, BE-ja e zgjeruar ka peshë më të madhe dhe luan rolin e një aktori më të fuqishëm ndërkombëtar.

Përveç se nxit solidaritetin financiar dhe ekonomik dhe mundësitë për konsumatorët, BE-ja është edhe bashkësi vlerash. Ne jemi familje në rritje e shteteve demokratike evropiane të përkushtuara të punojnë së bashku për paqe dhe liri, prosperitet dhe drejtësi sociale. Dhe ne i mbrojmë këto vlera. Ne përpiqemi të nxisim bashkëpunim mes popujve të Evropës, duke respektuar dhe ruajtur shumëllojshmërinë tonë.

Zgjerime të njëpasnjëshme

Organizata e formuar në vitin 1957 që sot njihet si Bashkimi Evropian, kishte fillimisht gjashtë anëtarë: Belgjikën, Francën, Gjermaninë, Italinë, Luksemburgun dhe Hollandën.

Në vitin 1973, u anëtarësuan Danimarka, Irlanda dhe Britania e Madhe. Në vitin 1981 u bashkangjiti Greqia, kurse Spanja dhe Portugalia në vitin 1986. Austria, Finlanda dhe Suedia u anëtarësuan në vitin 1995.

Në vitin 2004, gjatë zgjerimit më të madh të të gjitha kohërave të BE-së, shtete anëtare u bënë Qiproja, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia.

Në janar të vitit 2007 u anëtarësuan Bullgaria dhe Rumania, duke rritur numrin e shteteve anëtare në 27.



Kush mund të bëhet anëtar?

Kërkesat për t'u bërë pjesë e BE-së janë shprehur me përpikmëri përgjatë rrjedhës së zhvillimit të saj, në mënyrë që të jenë të qarta për qytetarët dhe t'i udhëzojnë shtetet që duan të anëtarësohen.

Neni 49 i Traktatit të Bashkimit Evropian thotë që çdo shtet evropian mund të kërkojë të bëhet anëtar nëse respekton vlerat demokratike të BE-së dhe angazhohet t'i promovojë ato.

Një shtet mund të bëhet anëtar vetëm nëse i plotëson të gjitha kriteret për pranim, ashtu siç janë përcaktuar në fillim nga Këshilli Evropian në Kopenhagë në vitin 1993, dhe të përforcuara në vitin 1995. Këto kriterë janë:

Neni 2, Traktati i Bashkimit Evropian

“Unioni bazohet në parimet e respektit për dinjitetin njerëzor, lirinë, demokracinë, barazinë, shtetin ligjor dhe respektimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Këto parime janë të përbashkëta për Shtetet Anëtare[...].”

Neni 49, Traktati i Bashkimit Evropian

“Çdo shtet evropian që respekton parimet e shpallura në nenin 2 dhe do të angazhohet t’i promovojë ato, mund të kërkojë të bëhet anëtar i Unionit.”

1. *Politike*: Institucione stabile që garantojnë demokraci, shtet ligjor, të drejta të njeriut dhe respekt dhe mbrojtje për minoritetet.
2. *Ekonomike*: Ekonomi funksionale të tregut dhe aftësi për të përballuar konkurrencën dhe forcat e tregut të BE-së.
3. *Aftësia për të marrë përsipër detyrimet* që sjell anëtarësimi, duke përfshirë besnikërinë ndaj qëllimeve të përbashkëta politike, ekonomike dhe monetare.


Gjithashtu, është BE-ja ajo që duhet të jetë në gjendje të integrojë anëtarë të rinj, pra BE-ja ruan të drejtën për të vendosur se kur është e gatshme t'i pranojë ata.



Ku qëndrojmë ne?

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian u kanë dhënë mundësinë për anëtarësim në BE shteteve të Ballkanit Perëndimor, Turqisë dhe Islandës. Ato janë në faza të ndryshme të procesit të zgjerimit.

Turqia, Kroacia, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Islanda dhe Mali i Zi janë shtete kandidate. Nga këto shtete, në zhvillim e sipër janë negociatat me Islandën dhe Turqinë. Kroacia tashmë ka përfunduar negociatat për pranim.



* Nën Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit

Kush vendos?

Anëtarët e rinj pranohen me pëlqimin unanimitë të qeverive të shteteve anëtare në BE të zgjedhura në mënyrë demokratike, që mbledhen së bashku, qoftë në Këshillin e Ministrave ose në Këshillin Evropian.

Kur një shtet kërkon të bëhet anëtar i BE-së, qeveritë e shteteve anëtare, të përfaqësuara në Këshill, vendosin - pas marrjes së mendimit nga Komisioni - nëse kërkesa do të pranohet dhe nëse shteti do të njihet si kandidat. Gjithashtu, Shtetet Anëtare vendosin se kur dhe në çfarë kushtesh do të hapen dhe mbyllen negociatat për pranim me kandidatët në çdo fushë politike, duke marrë parasysh rekomandimet e Komisionit Evropian.

Dhe janë Shtetet Anëtare ato që vendosin nëse negociatat përfundojnë në mënyrë të suksesshme.

Traktati i Anëtarësimit duhet të nënshkruhet nga çdo Shtet Anëtar dhe kandidati i interesuar. Pastaj ai duhet të ratifikohet nga çdo shtet anëtar dhe shteti i interesuar sipas procedurave të tyre të vendosura me kushtetutë. Parlamenti Evropian, anëtarët e të cilit zgjidhen drejtpërsëdrejti nga banorët e BE-së, duhet gjithashtu të japë pëlqimin e tij.



Si funksionon procesi i zgjerimit: plotësimi i kërkesave

Për t'u siguruar që zgjerimi sjell dobi për BE-në, por njëkohësisht edhe për shtetet që janë në proces për t'u anëtarësuar, procesi i pranimit duhet të menaxhohet me kujdes. Kandidatët duhet të demonstrojnë se do të jenë në gjendje ta luajnë plotësisht rolin e tyre si anëtarë - gjë që kërkon mbështetje të madhe nga shtetasi e tyre, si dhe pajtim politik dhe teknik me normat dhe standardet e BE-së. Përgjatë procesit, nga kërkesa për pranim deri tek anëtarësimi, BE-ja përdor procedura pranimi hap-pas-hapi.

Për t'u ndihmuar shteteve të përgatiten për anëtarësim në të ardhmen, BE-ja ka krijuar një strategji para-anëtarësuese. Elementet kyçe të kësaj strategjie përfshijnë marrëveshje që përcaktojnë të drejta dhe detyrime (si Marrëveshjet për Stabilizim dhe Asocim në rastin e Ballkanit Perëndimor), si dhe mekanizma të veçantë për bashkëpunim siç janë Partneritetet Anëtarësuese ose Partneritetet Evropiane, duke përcaktuar objektiva konkrete për reforma që duhet të arrihen nga shtetet kandidate dhe kandidatët potencialë. Ndihma financiare nga BE-ja, është një aspekt tjetër i rëndësishëm i strategjive para-anëtarësuese.

Negociatat për pranim

Negociatat për pranim përfshijnë aftësinë e kandidatit për t'i marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit. Termi '*negociata*' mund të keqkuptohet. Negociatat e pranimit kanë në qendër të vëmendjes kushtet dhe kohën e adaptimit të kandidatit, implementimin dhe zbatimin e rregullave të BE-së, prej rreth 100,000 faqe. Dhe

këto rregulla (të njohura edhe si *acquis*, nga frengjishtja "*ajo për të cilën është rënë dakord*") nuk janë të negociueshme. Për kandidatët, kjo është thelbësisht një çështje e pranimit se si dhe kur të miratohen dhe zbatohen ligjet dhe procedurat e BE-së. Për BE-në, është e rëndësishme që të marrë garanci mbi datën dhe efikasitetin e zbatimit të rregullave nga çdo kandidat.

Negociatat zhvillohen mes Shteteve Anëtare të BE-së dhe çdo shteti kandidat, dhe ritmi i tyre varet nga progresi individual i çdo shteti në plotësimin e kërkesave. Rrjedhimisht, kandidatët janë të nxitur të zbatojnë reformat e nevojshme shpejt dhe në mënyrë efektive. Disa nga këto reforma kërkojnë transformime të shumta dhe ndonjëherë të vështira të strukturës politike dhe ekonomike të shtetit. Prandaj është e rëndësishme që qeveritë t'u publikojnë qartë dhe bindshëm shtetasve të tyre arsyen e këtyre reformave. Mbështetja nga shoqëria civile është esenciale për këtë proces. Seancat e negociatave mbahen në nivel të ministrave ose deputetëve, pra, Përfaqësues të Përhershëm për Shtetet Anëtare, dhe Ambasadorë ose Negociatorë Kryesorë për shtetet kandidate.

Për të lehtësuar negociatat, i gjithë organi ligjor i BE-së ndahet në "kapituj", ku secili kapitull i përgjigjet një fushe të politikës. Hapi i parë gjatë negociatave është i ashtuquajtur "*screening*" (shqyrtim analitik); *qëllimi* i tij është identifikimi i fushave që kanë nevojë për përmirësime në legjislacion, institucione ose praksën e një shteti kandidat.

Kapitujt e acquis-së

1. Lëvizja e lirë e mallrave
2. Liri në lëvizjen e punëtorëve
3. E drejta e krijimit dhe liria për ofrimin e shërbimeve
4. Lëvizja e lirë e kapitalit
5. Prokuroria publike
6. Ligji lidhur me ndërmarrjet
7. E drejta mbi ligjin e pronës intelektuale
8. Politika e konkurrencës
9. Shërbimet financiare
10. Teknologjitë e informimit dhe media
11. Bujqësia dhe zhvillimi rural
12. Siguria e ushqimit, veterinaria dhe politika fitosanitare
13. Peshkataria
14. Politika e transportit
15. Energjia
16. Taksat
17. Politika ekonomike dhe monetare
18. Statistika
19. Politika sociale dhe punësimi
20. Politika e ndërmarrjeve dhe politika industriale
21. Rrjetet jashtë-evropiane
22. Politika rajonale dhe koordinimi i mjeteve strukturore
23. Gjyqësia dhe të drejtat themelore
24. Drejtësia, liria dhe siguria
25. Shkenca dhe hulumtimi
26. Arsimi dhe kultura
27. Ambienti jetësor
28. Mbrojtja e konsumatorit dhe mbrojtja e shëndetit
29. Unioni doganor
30. Marrëdhëniet e jashtme
31. Politika e punëve të jashtme, sigurisë, dhe e mbrojtjes
32. Kontrolli financiar
33. Dizpozitat financiare dhe buxhetore
34. Institucionet
35. Çështje të tjera

Si bazë për nisjen e procesit teknik të negociatave, Komisioni bën *“raport progresi”* për çdo kapitull dhe çdo shtet. Këto raporte i dorëzohen Këshillit. Komisioni vendos se a do të hapë apo jo negociatat për një kapitull të caktuar, ose do të kërkojë që më parë të plotësohen disa kushte të caktuara (ose standarde të ashtuquajtura “benchmarks” apo pika referuese).

Atëherë shteti kandidat paraqet një *qëndrim mbi negociatat*. Në bazë të një propozimi nga Komisioni, Këshilli miraton një qëndrim të përbashkët të BE-së që lejon hapjen e negociatave.

Kur BE-ja pranon një *qëndrim të përbashkët* për çdo kapitull të *acquis*-së, dhe kur kandidati pranon këtë qëndrim të përbashkët të BE-së, negociatat për atë kapitull mbyllen - por vetëm përkohësisht. Negociatat për pranim në BE funksionojnë nën parimin “asgjë nuk është vendosur derisa nuk vendoset gjithçka”, pra, përmbyllja përfundimtare e kapitujve bëhet vetëm në fund të gjithë procesit të negociatave.

Raporti i progresit Kroaci, Kapitulli 20 - Politika e ndërmarrjeve dhe politika industriale

*“III. Vlerësimi i shkallës së Harmonizimit
dhe kapacitetit të zbatimit*

*Në përgjithësi, Kroacia ka arritur nivel të
kënaqshëm të shtrirjes të acquis-së; ajo
duhet të finalizojë strategjinë industriale
dhe të përmirësojë kapacitetin për të
vlerësuar konkurrencën industriale dhe
të përmirësojë analizat dhe formulimet e
politikës[...].”*





Raportimi dhe monitorimi

Komisioni informon rregullisht Këshillin dhe Parlamentin Evropian për progresin e shteteve kandidate, përmes *raporteve vjetore strategjike dhe raporteve individuale për zhvillimin e shtetit*. Ai gjithashtu monitoron plotësimet e standardeve dhe progresin në respektimin e ndërmarrjeve. Raportet e progresit u ofrojnë shteteve përgjigje të vlefshme dhe shënojnë fushat kryesore që kanë akoma nevojë për përmirësim.

Raporti i progresit 2010 mbi Turqinë, Kapitulli 25, “Shkenca dhe hulumtimi”

“Në fushën e politikës për shkencë dhe hulumtim, mund të raportohet një përparim i dukshëm. Është bërë një numër i madh i marrëveshjeve rregullatore, për të inkurajuar hulumtuesit e huaj të qëndrojnë më gjatë ose të vendosen përgjithmonë në Turqi. Ka filluar një program i ri për mbështetje që inkurajon kthimin në Turqi të hulumtuesve turq, të cilët kanë mbaruar studimet e doktoraturës por që aktualisht jetojnë jashtë shtetit.

Turqia është e përgatitur mirë në fushën e shkencës dhe hulumtimit dhe është arritur një përparim i madh drejt integritimit në të ardhmen në Fushën Evropiane të Hulumtimit. Në përgjithësi, shkalla e suksesit dhe pjesëmarrjes së Turqisë në Programet Kornizë është në rritje. Sidoqoftë, janë të nevojshme përpjekje më të mëdha për të ruajtur këtë shkallë gjatë Programit të shtatë Kornizë për Hulumtim dhe Zhvillim Teknologjik (FP7).”

Monitorimi vazhdon deri në fazën e pranimit. Kjo bën të mundur që të jepen këshilla plotësuese derisa shtetet pranojnë përgjegjësitë e anëtarësimit, dhe gjithashtu u garanton Shteteve aktuale Anëtare që anëtarët e rinj i plotësojnë kushtet për pranim.

Traktati i Pranimit

Kur negociatat rreth gjithë kapitujve mbarojnë në përputhje me të dyja palët, rezultatet përfshihen në një *propozim Traktat të Anëtarësimit*. Nëse fiton mbështetjen e Komisionit, Këshillit dhe Parlamentit Evropian, Traktati nënshkruhet dhe ratifikohet nga shteti kandidat dhe gjithë Shtetet Anëtare.

Nga nënshkrimi i Traktatit të Anëtarësimit e deri tek Anëtarësimi

Kur nënshkruhet Traktati i Anëtarësimit, shteti kandidat bëhet "*Shtet i Pranuar*" dhe ka të drejtën e disa privilegjeve të përkohshme derisa të bëhet shtet anëtar i BE-së. Si shtet i miratuar, ka të drejtë të diskutojë rreth projekt propozimeve, komunikatave, rekomandimeve ose iniciativave të BE-së, dhe merr "statusin e vëzhguesit aktiv" në organet dhe agjencitë e BE-së, ku ka të drejtë të fjalës por jo të votës. Kur mbaron procesi i ratifikimit, Traktati i Anëtarësimit hyn në fuqi në datën e caktuar, dhe Shteti i Pranuar bëhet Shtet Anëtar.



Ndihma e shteteve kandidate në përgatitjet për anëtarësim

Përparimi i një shteti kandidat drejt BE-së varet nga ajo se si është duke i zbatuar reformat e nevojshme për t'i përmbushur kriteret për praninë. BE-ja u ofron ndihmë shteteve gjatë përgatitjes së tyre për praninë në BE.

Lidhjet zyrtare të shteteve kandidate me BE-në mund të vendosen përmes marrëveshjeve të ndryshme. Për shembull, lidhjet zyrtare të Turqisë me BE-në në fillim u paraqitën në një marrëveshje të nënshkruar në vitin 1963 ("Marrëveshja e Ankarasë"), e cila që atëherë është azhurnuar vazhdimisht, dhe për të cilën është rënë dakord në Unionin Doganor, në vitin 1995. Për shtetet e Ballkanit Perëndimor është krijuar një proces i veçantë në vitin 2000, nën emrin *Procesi për Stabilizim dhe Asocim* (SAP). Procesi për Stabilizim dhe Asocim ka tre qëllime kryesore, pra stabilizimin dhe tranzicionin e shpejtë të ekonomisë së tregut, nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe perspektivën për praninë në BE. Ai ndihmon shtetet e rajonit të ndërtojnë kapacitetin e tyre për të pranuar dhe zbatuar standardet evropiane. Në kornizën e kësaj Marrëveshjeje, BE-ja u ofron shteteve të Ballkanit Perëndimor koncesione tregtare, lidhje kontraktuale dhe ndihmë ekonomike dhe financiare. Që nga viti 1991 deri në vitin 2011, BE-ja ka siguruar mbi 16 miliardë euro ndihmë për Ballkanin Perëndimor, një nga ndihmat më të mëdha në botë për frymë.

Shtetet kandidate duhet të zbatojnë reforma të rëndësishme për t'u siguruar që rregullat e BE-së jo vetëm që pranohen, por edhe zbatohen siç duhet. Ndoshta do të kenë nevojë të krijojnë organe të reja, siç është autoriteti për konkurrencë të lirë, ose një agjenci për standarde ushqimore. Ose, mund të kenë nevojë për ristrukturim të institucioneve ekzistuese: çmilitarizimin e



Kroacia

policisë, ngritjen e nivelit të mbikqyrjes së sigurisë nukleare dhe të ambientit jetësor, ose për t'u dhënë prokurorëve më shumë përgjegjësi në luftën kundër korrupsionit.

Këto reforma nënkuptojnë investime të mëdha si në aspektin e njohurive dhe zotësive teknike, ashtu edhe në aspektin financiar. BE-ja ofron një sërë programesh plotësuese dhe mekanizma për sigurimin e ndihmave financiare e teknike për t'i zbatuar këto reforma. E vetëdijshme për sfidat që reformat mund të paraqesin për shtetasit e vendeve kandidate, BE-ja gjithashtu mbështet strategji për rritjen e perceptimit të procesit të pranimit, duke përfshirë këtu dialogun mes shteteve të BE-së dhe shteteve kandidate në nivel të shoqërisë civile: sindikatave, shoqatave të konsumatorëve dhe organizatave të tjera joqeveritare.



Islanda

Një aspekt i rëndësishëm i ndihmës së BE-së është forcimi i kapacitetit institucional, ose "ndërtimi institucional", duke krijuar struktura ose duke trajnuar stafin përgjegjës për zbatimin e rregullave të BE-së në shtetin kandidat. Këshillat për zbatimin e acquis-së jepen zakonisht përmes marrëveshjeve të ashtuquajtura "Tuining", ku



Turqia



Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë

ekspertët delegohen nga Shtetet Anëtare të BE-së, ose përmes punëtorive afatshkurtra.

Përgatitja e shteteve për anëtarësim, gjithashtu nënkupton ndihma për rritjen e nivelit të infrastrukturës së tyre: ndërtimin e implantëve solide për deponimin e mbeturinave ose përmirësimin e rrjeteve të transportit përmes një kombinimi grantesh nga ndihma e BE-së dhe kredive nga institucione financiare ndërkombëtare. Shteteve kandidate iu lejohej të marrin pjesë në programet e BE-së, për shembull në fushën e shëndetit publik, hulumtimit ose arsimit. Kjo përvojë mundëson që shtetet kandidate të mësohen të përballojnë llojet e fondeve që do t'u takojnë pas pranimit, si dhe ndihmon të njohin nga afër politikat dhe mjetet e BE-së.

Që nga viti 2007, edhe shtetet kandidate edhe ato që janë kandidate potenciale kanë pranuar fonde

dhe ndihmë nga BE-ja nëpërmjet të një kanali të vetëm - *Instrumentit të ndihmës për para-anëtarësim*, ose IPA.

Projektet që mbështeten nga IPA kanë për qëllim të forcojnë institucionet demokratike dhe shtetin ligjor, të bëjnë reforma në administratën publike, të kryejnë reforma ekonomike, të nxisin respektin për të drejtat e njeriut si dhe të drejtat e pakicave dhe barazisë gjinore, të mbështesin zhvillimin e shoqërisë civile dhe të rrisin bashkëpunimin rajonal, dhe të kontribuojnë në zhvillimin e vazhdueshëm për zvogëlimin e skamjes. Për shtetet kandidate, synimi tjetër është pranimi dhe zbatimi i kërkesave të plota për anëtarësim.

Financimi i përgjithshëm i para-pranimit për periudhën e viteve 2007-2013 është 11.5 miliardë euro, me një ndarje të kujdesshme që vendoset vit pas viti.



Mali i Zi

Korniza Treguese Financiare për Instrumentin e ndihmës para-anëtarësuese (IPA) deri në vitin 2013 (miliona euro, çmimet momentale)

	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
<i>Turqia</i>	497.2	538.7	566.4	653.7	781.9	899.5	935.5
<i>Kroacia</i>	141.2	146.0	151.2	153.6	156.6	159.7	163.0
<i>Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë</i>	58.5	70.2	81.8	91.7	98.0	105.1	117.2
<i>Serbia</i>	189.7	190.9	194.8	197.9	201.9	205.9	214.8
<i>Mali i Zi</i>	31.4	32.6	34.5	33.5	34.1	34.8	35.4
<i>Kosova</i> (Nën Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit)	68.3	187.7	106.1	67.3	68.7	70.0	73.7
<i>Bosnja dhe Hercegovina</i>	62.1	74.8	89.1	105.4	107.4	109.5	111.8
<i>Shqipëria</i>	61.0	73.8	81.2	94.2	94.4	96.3	98.1
<i>Islanda</i>	-	-	-	-	10.0	12.0	6.0
<i>Programi shumë-përfitues</i>	129.6	137.7	188.9	146.6	191.6	162.5	183.9
GJITHSEJ	1239.0	1449.4	1494.0	1543.9	1744.6	1861.3	1939.4

E ardhmja

Zgjerimi në të ardhmen përfshin shtetet e Evropës Juglindore dhe Islandën. Është në dobi të gjithë Evropës të nxisë transformimin demokratik në Ballkanin Perëndimor dhe në Turqi dhe të forcojë stabilitetin, si dhe të thellojë bashkëpunimin afatgjatë që ka pasur me Islandën.

Në dhjetor të vitit 2006, Këshilli Evropian ripërtëriu konsenzusin për zgjerim. BE-ja i ka marrë seriozisht shqetësimet e qytetarëve të vet rreth shpejtësisë të zgjerimit. Politika e zgjerimit bazohet në *konsolidim*. Kjo do të thotë që BE-ja respekton angazhimet e shteteve që tashmë janë në proces për t'u anëtarësuar, por ka qëndrim të matur sa u përket angazhimeve të reja. Për të gjitha shtetet kandidate dhe kandidatët potencialë zbatohet *kushtëzim* rigoroz. Datat e mundshme për pranimin e tyre varen nga përparimi i tyre në aspektin ekonomik dhe në aspektin e reformave si dhe pajtimi me organet ligjore të BE-së. Çdo shtet do të vlerësohet sipas meritave të veta.

Në mënyrë që zgjerimi të jetë i suksesshëm, është esenciale të sigurohet mbështetja e qytetarëve si në Shtetet Anëtare të BE-së ashtu edhe në shtetet kandidate ose kandidate potenciale. Është me rëndësi që sukseset dhe sfidat e zgjerimit të kumtohen më mirë, që të fitohet mbështetja publike dhe zhvillimi i bashkërisëm të bëhet një projekt i përbashkët.

Angazhimi i BE-së me procesin e zgjerimit reflekton bindjen e Shteteve Anëtare se zgjerimi është interesi ynë i përbashkët. Procesi i zgjerimit është një pjesë e zgjidhjes së shqetësimeve të shumë qytetarëve tanë, qofshin ato lidhur me parandalimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit apo lidhur me krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimit. Duke arritur sukses në zgjerimin aktual, BE-ja do të mund t'i përballojë më mirë sfidat që do t'i hasë nesër.



Historia e procesit

- 1957 Belgjika, Franca, Gjermania, Italia, Luksemburgu dhe Holanda nënshkruajnë Traktatin e Romës dhe krijojnë Komunitetin Ekonomik Evropian (EEC).
- 1963 Marrëveshja e Ankarasë e nënshkruar me Turqinë.
- 1973 Danimarka, Irlanda dhe Britania e Madhe i bashkangjiten Komunitetit Ekonomik (EC).
- 1981 Greqia i bashkangjitet Komunitetit Ekonomik.
- 1986 Spanja dhe Portugalia i bashkangjiten Komunitetit Ekonomik.
- 1987 Turqia kërkon të bëhet pjesë e Komunitetit Ekonomik.
- 1990 Pas bashkimit të Gjermanisë, integrimi i ish Republikës Demokratike Gjermane.
- 1993 Këshilli Evropian i Kopenhagës bie dakord rreth kriterëve të pranimit.
- 1994 Islanda bëhet pjesë e Zonës Ekonomike Evropiane, që lejon atë të marrë pjesë në tregun e përbashkët.
- 1995 Austria, Finlanda and Suedia bëhen pjesë e BE-së. Unioni Doganor me Turqinë.
- 1999 Këshilli Evropian i Helsinkit miraton Turqinë si shtet kandidat.
- 2000 Samiti i Zagrebit miraton angazhim të plotë për Procesin e Stabilizimit dhe Asocimit në Ballkanin Perëndimor. Islanda bëhet pjesë e marrëveshjes Shengen për lëvizjen e lirë të njerëzve.
- 2003 Kroacia kërkon të anëtarësohet në BE. Samiti i Selanikut rikonfirmon angazhimin e BE-së për integrim të shteteve të Ballkanit Perëndimor në BE.
- 2004 Qiproja, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia anëtarësohen në BE. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë kërkon të bëhet pjesë e BE-së.
- 2005 Hapja e negociatave për pranim me Turqinë dhe Kroacinë. Fillon "screening" (shqyrtimi analitik) për Turqinë dhe Kroacinë. Ish Republikës Jugosllave së Maqedonisë i jepet statusi i kandidatit.
- 2007 Bullgaria dhe Rumania bashkohen me BE-në.
- 2008 Mali i Zi kërkon të bëhet pjesë e BE-së.
- 2009 Shqipëria, Islanda dhe Serbia kërkojnë të bëhen pjesë e BE-së.
- 2010 Hapja e negociatave për anëtarësim me Islandën. Këshilli Evropian konfirmon Malin e Zi si shtet kandidat.
- 2011 Përfundimi i negociatave të anëtarësimit me Kroacinë.

Komisioni Evropian — Drejtoria Gjenerale për Zgjerim

Të kuptojmë zgjerimin — Politika e Bashkimit Evropian për Zgjerim

Luksemburg: Zyra për Botime e Bashkimit Evropian

2011 — 17 pp. — 16 x 23 cm

ISBN 978-92-9238-038-0

DOI 10.2871/35197

Numri i katalogut: MK-30-11-295-SQ-C

Kontakti me BE-në



■ ONLAJN

Informata në të gjitha gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian mund të gjeni në ueb faqen Europa: europa.eu



■ PERSONALISHT

Në mbarë Evropën ka qindra qendra lokale informative të BE-së.
Adresën e qendrës më të afërt mund ta gjeni në ueb faqen Europe Direct:
europedirect.europa.eu



■ PËRMES TELEFONIT OSE POSTËS

Europe Direct është shërbim që u përgjigjet pyetjeve tuaja lidhur me Bashkimin Evropian. Këtë shërbim mund ta kontaktoni në telefonin pa pagesë **00 800 6 7 8 9 10 11**, telefonin me pagesë nëse merrni nga vendet jashtë BE-së **+32 2 299 96 96** ose me anë të postës elektronike të ueb faqes Europe Direct: europedirect.europa.eu



■ LEXONI MBI EVROPËN

Për të lëxuar botimet mbi BE-në, vetëm duhet të klikoni një herë në ueb faqen e librarisë të BE-së: bookshop.europa.eu

Qendra Informative e Unionit Evropian

M.H.Jasmin 52v
1000 Shkup
Tel./faks. 02/3296-363
Internet: www.euic.mk
E-mail: euinfo@euic.mk

Delegacioni i Bashkimit Evropian

M.H.Jasmin 52v
1000 Shkup
Tel. 02/3248 500
Faks. 02/3248 501
Internet: www.delmkd.ec.europa.eu
E-mail: Delegation-FYRMacedonia@ec.europa.eu

Pika Informative e UE - Gostivar

Braca Ginovski nr. 61
1230 Gostivar
Tel./Faks. 042/218-167
E-mail: gostivar@euinfopoint.mk

Pika Informative e UE - Koçan

Rade Kratoŭçe nr.1
2300 Koçan
Tel. 033/279-554
Faks. 033/279-962
E-mail: kocani@euinfopoint.mk

Pika Informative e UE - Kumanovë

11 Oktomvri bb
1300 Kumanovë
Tel./Faks. 031/475-800
E-mail: kumanovo@euinfopoint.mk

Pika Informative e UE - Kavadar

Marshal Tito bb
1430 Kavadar
Tel./Faks. 043/416-107
E-mail: kavadarci@euinfopoint.mk

Pika Informative e UE - Manastir

1 Maj bb
7000 Manastir
Tel./Faks. 047/234-234
E-mail: bitola@euinfopoint.mk

Pika Informative e UE - Veles

Panko Brashnar nr.1
1400 Veles
Tel. 043/232-406; lok. 226
Faks. 043/232-966
E-mail: veles@euinfopoint.mk

Pika Informative e UE - Tetovë

Dervish Cara bb
1200 Tetovë
Tel. 070/548-576
E-mail: tetovo@euinfopoint.mk

Në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian ka përfaqësi të Komisionit dhe zyra e përfaqësi të Parlamentit Evropian. Komisioni Evropian ka gjithashtu edhe delegacione në vende të tjera të botës.

SI TË SIGUROJMË BOTIME NGA BE-JA

Botime pa pagesë:

- Përmes librarisë së BE-së (<http://bookshop.europa.eu>);
- në përfaqësitë ose delegacionet e Bashkimit Evropian. Mund të gjeni informatat për kontakt në internet (<http://ec.europa.eu>) ose duke dërguar një faks tek: +352 2929-42758.

Botime me pagesë:

- përmes librarisë së BE-së (<http://bookshop.europa.eu>).

Abonime me pagesë (p.sh. seritë vjetore të Gazetës Zyrtare të Bashkimit Evropian dhe raportet nga rastet para Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian):

- përmes njërit prej agentëve shitës nga Zyra e Botimeve e Bashkimit Evropian (http://publications.europa.eu/others/agents/index_en.htm).

Më shumë informata rreth zgjerimit do të gjeni në ueb faqen e Drejtorisë Gjenerale për Zgjerim të Komisionit Evropian.

<http://ec.europa.eu/enlargement/>

MK-30-11-295-SQ-C

Komisioni Evropian - Drejtoria Gjenerale për Zgjerim
Njësia A2: Informata dhe Komunikim
Adresa e zyrës: Rue de la Loi 170, B-1049 Bruksel
Tel: (+32-2) 299.06.66 Fax: (+32-2) 299.17.77

Për informata lidhur me çdo aspekt të politikës së BE-së
telefononi Europe
Direct kudo nga BE-ja:
00800 6 7 8 9 10 11



ISBN 978-92-9238-038-0



9 789292 380380